

VENDIM
Nr.115, datë 28.12.2010

PËR HEQJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË “ANTEA CEMENT” SHA DHE RIKTHIMIN NË STATUSIN E KLIENTIT TARIFOR PO KËSAJ SHOQËRIE PËR OBJEKTIN “FABRIKA E ÇIMENTOS PRANË BORIZANËS, KRUIJË”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 germa “a” dhe 8 të rregullores “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor për objektin “Fabrika e çimentos, pranë Burizanës, Krujë”

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe të heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe të vendimit nr.8, datë 29.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitim të statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010. “CEZ shpërndarja” sh.a., me shkresën nr.8550/1, datë 17.12.2010, konfirmon se është e gatshme të furnizojë me energji elektrike, duke filluar nga data 1.1.2011, shoqërinë “Antea Cement” sh.a. nën skemën e çmimeve të rregulluara të miratuara nga ERE për vitin 2011.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. T’i heqë statusin e klientit të kualifikuar shoqërisë “Antea Cement” sh.a. dhe rikthimin e saj në statusin e klientit tarifor për objektin “Fabrika e çimentos pranë Borizanës, Krujë”, duke filluar nga data 1 janar 2011.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta